



QEVERIA E MALITTË ZI

Ekipi bashkërendues për implementimin e Strategjisë komunikuese
për integrimet euro-atlantike

Ç'është **NATO**?

Podgoricë, prill 2008



Botimi i këtij informatori u mundësua nga



KOHA
Javore

Qëllimi i Aleancës dhe detyrat themelore të sigurisë

Aleanca Veri-Atlantike (NATO-North Atlantic Treaty Organization) është pakt i 26 vendeve nga Amerika Veriore dhe Evropa, i përkushtuar përmbushjes së objektivave të Traktatit veri-atlantik të nënshkruar me 4 prill të vitit 1949 ne Uashington.

Në përputhje me traktatin, objektivi themelor i NATO-s është që të ruaj dhe të mbroj sigurinë e vendeve anëtare, qoftë me mjete politike, qoftë me ato ushtarake dhe të mundësojnë mbrojtjen e vlerave të përbashkëta themelore: demokracisë, lirive të njeriut, solidaritetit, mirëqenies, paqes, stabilitetit dhe pushtetit të së drejtës.

Vendet anëtare të NATO-s janë: **Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Çekia, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Turqia, Britania Madhe dhe SHBA-ja. Nga vendet anëtare të NATO-s, Turqia, Islanda e Norvegjia nuk janë anëtare të BE-së. Nga vendet anëtare të BE-së anëtare të NATO-s nuk janë Austria, Suedia, Finlanda, Irlanda (në Partneritetin për Paqe), Qiproja dhe Malta.**

Qëllim themelor i Aleancës Veri-Atlantike është që të ofroj mbrojtjen e lirisë dhe sigurisë të të gjitha vendeve anëtare në Evropë dhe në Amerikën Veriore në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Për te realizuar këtë, Aleanca zhvillon dhe shfrytëzon si ndikim politik ashtu edhe kapacitetet e veta ushtarake, varësisht nga natyra e kanosjeve ndaj sigurisë, me të cilat përballen shtetet anëtare të Aleancës. Ashtu siç ndryshoi ambienti strategjik përreth, ashtu ndryshoi edhe mënyra me të cilën Aleanca reagon në këto sfida ndaj sigurisë. Ajo vazhdon të ruaj stabilitetin anekënd rajonit euroatlantik dhe transformohet për tu bërë ballë me sukses kanosjeve të reja siç janë terrorizmi dhe sfidat e tjera ndaj sigurisë, që tejkalojnë larg sferën e saj të përgjegjësisë.

Mbrojtja kolektive

Aleanca funksionon mbi parimin që siguria e secilit vend anëtar, varet nga siguria e tërësishme e të gjitha vendeve anëtare. Në qoftë se është rrezikuar siguria e cilësdo prej tyre, kjo do të ketë ndikim në të gjitha vendet anëtare. Duke nënshkruar Traktatin e Uashingtonit, Kartën themeluese të NATO-s, secili nga shtetet anëtare mori përsipër detyrimin karshi vendeve të tjera anëtare se do ta respektojë këtë parim, duke ndarë rreziqet dhe përgjegjësinë, si dhe favorët që ofron mbrojtja kolektive. Secili

vend është i pavarur dhe i lirë për të marrë vendimet e veta, mirëpo përmes planifikimit të përbashkët dhe ndarjes së resurseve, ato gëzojnë shkallën kolektive të sigurisë, që është shumë më e lartë nga ajo që do të mund ta arrinte secila prej tyre veç e veç. Ky mbetet parimi themelor i bashkëpunimit në sferën e sigurisë në kuadër të NATO-s.

Detyrat themelore të sigurisë

Koncepti strategjik i Aleancës, si deklaratë strategjike mbi qëllimet e Aleancës dhe detyrat themelore të sigurisë, jep direktiva për përdorimin e mjeteve politike dhe ushtarake në zbatimin e tyre. Detyrat themelore të Aleancës janë:

- **që të veprojë si themel i stabilitetit të rajonit euro-atlantik**
- **që të shërbej si forum konsultativ përkatës për çështjen e sigurisë**
- **që të shërbej si mjet për parandalimin dhe mbrojtjen nga kërcënimet apo nga agresioni ndaj cilitdo vend anëtar të NATO-s**
- **që të kontribuojë në parandalimin efektiv të konflikteve dhe të angazhohet aktivisht në zgjidhjen e krizave; dhe**
- **të promovojë spektrin e gjerë të marrëdhënieve të partneritetit, të bashkëpunimit dhe të dialogut me vendet tjera.**

Ndonëse në Evropë është zhdukur kanosja nga një luftë e përgjithshme, vendet anëtare të Aleancës dhe vendet e tjera në regionin euro-atlantik po përballen me rreziqe dhe pasiguri të tjera, përfshirë këtu **konfliktet etnike, shkeljen e të drejtave të njeriut, jostabilitetin politik dhe brishtësinë ekonomike**. Problem tjetër, si **përhapja e armëve bërthamore, biologjike dhe kimike** dhe mënyra transferimit të tyre është çështje për të cilën duhemi të brengosemi seriozisht, kurse edhe zhvillimi i teknologjisë do të mund të rezultonte me rritjen e mundësive që armiku potencial të vijë deri tek një teknologji e tillë e sofistikuar. Aq më tepër, kur është fjala për aspektin e sigurisë, Aleanca duhet të marrë parasysh kontestin global dhe faktin se do të mund tu ekspozohet rreziqeve shumë më të mëdha, përfshirë edhe **aktet terroriste, sabotimet, kriminalitetin e organizuar si dhe rrezikimin e kanaleve për furnizimin e resurseve vitale**.



Si funksionon NATO?

NATO nuk është organizatë mbinacionale, por organizatë ndërshtetërore. Ai është pakt i **shteteve të pavarura dhe sovrane**, të cilat janë tubuar së bashku në interes të **sigurisë së përbashkët** dhe të mbrojtjes së vlerave të përbashkëta. Vendimet merren mbi bazën e **konsensusit**.

Çdo vend anëtar është i përfaqësuar nga delegacioni i përhershëm në selinë politike të NATO-s në Bruksel, të cilin e përbën përfaqësuesi i përhershëm, i cili kryeson delegacionin si dhe përfaqësuesi ushtarak.

Ndarja e strukturës civile nga ajo ushtarake në kuadër të NATO-s është bërë me qëllim që ajo të mund t'u përgjigjet dimensioneve politike dhe ushtarake të punës së Aleancës. Të dyja këto struktura i ofrojnë mbështetje **Paktit veri-atlantik** në kuadër të NATO-s, forumit më të lartë vendimmarrës.

Konsensusi dhe pajtimi i përgjithshëm

Aleanca mbështetet në përkushtimin e përbashkët ndaj bashkëpunimit praktik e reciprok në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Në NATO nuk ka procedura elektorale dhe vendimet merren mbi bazën e konsensusit dhe pëlqimit unanim. Kjo do të thotë që konsultimet politike janë pjesa themelore e procesit të marrjes së vendimeve. Të gjitha forumet e NATO-s përbëhen nga përfaqësuesit e vendeve anëtare, roli i të cilëve është që t'u përfaqësojnë pikëpamjet e vendit të vet aleatëve dhe t'i informojnë qeveritë e veta mbi qëndrimet e aleatëve të tjerë.

Këshilli Veri-Atlantik

Forumi më i rëndësishëm për marrjen e vendimeve në NATO është Këshilli Veri-Atlantik, i cili tubon përfaqësuesit e 26 vendeve anëtare në nivel ambasadorësh dhe mblidhet një herë në javë. Përveç kësaj, Këshilli mblidhet edhe në nivel të ministrave të punëve të jashtme apo të mbrojtjes, të shefave të qeverive apo të shteteve, varësisht nga tema që debatohet në seancat e Këshillit. Ekzistojnë disa organe ndihmëse të Këshillit, nga të cilët më të rëndësishmit janë Komiteti për planifikimin e mbrojtjes, Komiteti për planifikimin bërthamorë, Komiteti ushtarak dhe Komiteti politik. Në të gjitha komitetet gjithashtu zbatohet parimi i konsensusit – nuk ekziston votimi apo vendimmarrja sipas vullnetit të shumicës.


Nganjëherë ndodhë që shumica ka një qëndrim të përbashkët, por një apo disa vende kanë mendim tjetër. Në rast të tillë bëhet përpjekje që të afrohen qëndrimet me qëllim që të arrihet kompromisi. Natyrisht, ekziston mundësia që dallimet të mos mund të harmonizohen. Në rast të tillë, vendi anëtar i veçantë mund të vazhdojë lirisht aktivitetin që ka zgjedhur vet. Asnjë vend nuk është i detyruar të ndërmarrë aksione ose të marrë vendime kundër vullnetit të vet.

Transformimi i NATO-s

Politika të cilën e kanë miratuar vendet anëtare të NATO-s ka evoluar pa ndërprerë në frymën e ndryshimeve të ambientit strategjik përreth. Që nga përfundimi i luftës së ftohtë, politika e aleancës dhe struktura e sajë kanë pësuar ndryshime rrënjësore, në përputhje me një mori të tërë ndryshimesh në ambientin politik dhe ushtarak të Evropës, si dhe shfaqjes së kanosjeve të reja për siguri. Përveç kësaj, është zgjeruar edhe koncepti i mbrojtjes, në mënyrë që të përfshijë edhe dialogun dhe bashkëpunimin praktik me vendet e tjera jashtë aleancës, si njërin nga format më të mira të forcimit të sigurisë euro-atlantike.

Sot NATO është shumë më tepër se një pakt mbrojtës. Në fakt, ai arriti të depërtojë deri tek ish-kundërshtarët e vet dhe tani është duke punuar në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe të sigurisë anekënd rajonit euro-atlantik. Për të arritur këtë, Aleanca merr përsipër një numër gjithnjë e më të madh detyrash dhe gradualisht aplikon metoda të reja fleksibile dhe pragmatike për zgjidhjen e çështjeve pashmangshmërisht të ndërlikuara. Në këtë proces, roli qendror i NATO-s në garantimin e sigurisë së rajonit euro-atlantik madje është shtuar dhe shumë vende partnere kërkojnë të bëhen anëtare të ardhshme të aleancës.

Pas rënies së murit të Berlinit, pati sugjerime që NATO nuk është më i nevojshëm. Mirëpo, siguria euro-atlantike, ndonëse më pak e konfrontuar, u bë edhe më e ndërlikuar. Jashtë Evropës u shfaqën sfida të reja përfshirë shkatërrimin e disa shteteve, shumëzimin e armëve të shkatërrimit masiv dhe mënyrat e transferimit të tyre, si dhe terrorizmin.



Zgjerimi i sigurisë përmes partneritetit

Aleanca ka miratuar programin strategjik pas luftës së ftohtë, duke aplikuar një përkufizim më të gjerë të sigurisë dhe duke iniciuar mbi një bazë të gjerë strategjinë e partneritetit dhe të bashkëpunimit në mbarë rajonin euro-atlantik, e cila tani konsiderohet si njëra nga detyrat themelore të sigurisë së NATO-s. Ky proces filloi në vitin 1990 kur liderët e vendeve aleate ofruan dorën e miqësisë në zonën e ndarë lindje-perëndim, duke propozuar marrëdhënie të reja bashkëpunimi me vendet e Evropës Qendrore dhe asaj Lindore si dhe me ish republikat sovjetike.

Partneriteti për Paqe



Programi “Partneriteti për Paqe” është iniciativa më e rëndësishme e NATO-s e orientuar në forcimin e besimit dhe të bashkëpunimit në mes vendeve anëtare të aleancës dhe vendeve partnere, me qëllim të zhvillimit dhe forcimit të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin euro-atlantik. Vendet anëtare të Partneritetit për Paqe janë: **Shqipëria, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Finlanda, Gjeorgjia, Irlanda, Kazakistani, Kirgistani, Moldavia, Maqedonia, Rusia, Serbia, Suedia, Zvicra, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina dhe Uzbekistani.**

Mbështetur në bashkëpunimin praktik dhe në përkushtimin ndaj parimeve demokratike, që janë themel i vetë Aleancës, **qëllim i Partneritetit për Paqe është të rrisë stabilitetin, të zvogëlojë kërcënimet ndaj paqes dhe të ndërtojë marrëdhënie të forta në sferën e sigurisë ndërmjet vendeve anëtare (në veçanti) dhe NATO-s., si dhe me vendet e tjera partnere.** Esenca e programit PfP (Partnership for Peace) janë marrëdhëniet e partneritetit, të modeluara veç e veç midis secilit vend partner dhe NATO-s, të harmonizuara sipas nevojave individuale dhe të realizuara bashkërisht në shkallën dhe ritmin që zgjedh secila qeveri (më vetë) e cila merr pjesë në të.

Secila nga vendet partnere ka marr përsipër edhe detyrime të shumta afatgjate në ruajtjen e shoqërive demokratike; respektimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare; në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Karta e OKB-së, nga Deklarata mbi të drejtat universale të njeriut, nga Akti i Helsinkit dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi kontrollin e armëve dhe të armatimit, mbi heqjen dorë nga përdorimi i kërcënimeve dhe ushtrimi i dhunës kundër shteteve të tjera, mbi respektimin e kufijve ekzistues, mbi zgjidhjen paqësore të konflikteve.

Format e tjera të bashkëpunimit dhe partneritetit

NATO- Rusi

Bashkëpunimi NATO-Rusi fillon në vitin 1991 në kohën e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1994 Rusia u bë pjesë e Partneritetit për Paqe, kurse bashkëpunimi më i ngushtë u vendos me 27 maj 1997, me nënshkrimin e Aktit themelues mbi marrëdhëniet reciproke, bashkëpunimin dhe sigurinë midis NATO-s dhe Federatës Ruse. Bashkëpunimi aktual zhvillohet në kuadër të Këshillit NATO-Rusi, i cili mbledhet një herë në muaj në nivel ambasadorësh, dy herë



në vit në nivel ministrash, kurse varësisht nga nevojat mbledhet në nivelin e shefave të shteteve dhe qeverive. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, kurse bashkëpunimi zhvillohet në sferën e **luftës kundër terrorizmit, menaxhimit të krizave, parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit masiv, reformës së sistemit të mbrojtjes, të mbrojtjes civile, të bashkëpunimit shkencorë, të kontrollit të armatimit, të logjistikës, etj.**

NATO- Ukrainë

Marrëdhëniet NATO-Ukrainë janë formalizuar me nënshkrimin e **Kartës mbi partneritetin e veçantë midis NATO-s dhe Ukrainës** në Madrid, në korrik të vitit 1997. Komisioni i veçantë NATO-Ukrainë u formua në bazë të kartës së nënshkruar dhe mbledhet rregullisht në nivel të ambasadorëve dhe përfaqësuesve ushtarak. Në mbledhjen e Komisionit në Vilnius në vitin 2005, Ukraina u bë pjesë e Dialogut të intensifikuar me NATO-n.

Dialogu mesdhetar

Dialogu mesdhetar u iniciua në vitin 1994 nga Pakti veri-atlantik me qëllim të ndërtimit dhe forcimit të mirëbesimit reciprok përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit me shtetet që nuk janë anëtare të aleancës (**Egjipti, Izraeli, Mauritania, Maroku, Tunizia, Jordania dhe Algjeria**), për t'i kontribuar forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në Mesdhe dhe për të ndikuar në ndryshimin e perceptimit negativ për NATO-n ndër vendet anëtare të Dialogut Mesdhetarë. Dialogu i sipërpërmendur bazohet në marrëdhëniet dypalëshe midis secilit vend pjesëmarrës dhe Aleancës kurse përbëhet nga dialogu politik dhe nga pjesëmarrja në aktivitetet e veçanta që përfshijnë bashkëpunimin në fushën e **shkencës dhe të mbrojtjes së ambientit jetësor, të mbrojtjes civile të menaxhimit të krizave, të politikës së mbrojtjes, të kontrollit të kufijve.**

Iniciativa e Stambollit për bashkëpunim

Iniciativa e Stambollit për bashkëpunim u iniciua në Samitin e NATO-s të vitit 2004 me qëllim të përkrahjes të vendeve anëtare (**Bahrejni, Katari, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe**) në këto fusha: **reforma e sistemit të mbrojtjes, planifikimi dhe financimi i mbrojtjes, lufta kundër terrorizmit, parandalimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit masiv, lufta kundër trafikimit njerëzor, etj.**



Reagimi në situatat e jashtëzakonshme

Të gjitha vendet janë përgjegjëse të sigurojnë plane në shkallë kombëtare në rast situatash të jashtëzakonshme dhe fatkeqësish, përfshirë **derdhjen e lëndëve kimike apo toksike, ortekët, vërshimet dhe tërmetet** apo me qëllim të mënjanimit të pasojave të **sulmeve terroriste**. Mirëpo fatkeqësitë, qofshin ato të shkaktuara nga faktori njeri apo qofshin ato natyrore, nuk njohin kufij kombëtarë dhe prandaj bashkëpunimi dhe planifikimi në shkallë ndërkombëtare është i pazëvendësueshëm. Bashkëpunimi midis vendeve anëtare të NATO-s gjeti vendin e vet edhe në fushën e planifikimit në rast të situatave të jashtëzakonshme në afat shumëvjeçar. Kohë më parë, ky bashkëpunim është zgjeruar sa që përfshin edhe vendet partnere.

Bashkëpunimi në kuadër të NATO-s në rast situatash të jashtëzakonshme

Reagimet efektive ndaj katastrofave kërkojnë koordinim në sferën e transportit, të resurseve mjekësore, të komunikimit dhe burimeve tjera njerëzore, si dhe aftësi për të reaguar në situatat e jashtëzakonshme. NATO ka luajtur rol vendimtar në harmonizimin e planifikimit mes vendeve anëtare të saj, duke bërë të mundur që planet të funksionojnë mirë kur të jetë e nevojshme dhe duke bërë të mundur që resurset nga të cilët varet zbatimi i planeve, t'u vihen të gjithëve në dispozicion.



Bashkëpunimi i gjerë

Sot, përvojat e NATO-s dhe ekspertizat në fushën e planifikimit në rast situatash të jashtëzakonshme janë në dispozicion për të gjithë, por njëkohësisht shfrytëzojnë njohuritë dhe mundësitë e vendeve të tjera që marrin pjesë në punën e Këshillit të partneritetit euro-atlantik. Është shtuar edhe pjesëmarrja e vendeve partnere të NATO-s të cilat marrin pjesë aktive në format konkrete të bashkëpunimit në punën e komisioneve dhe komiteteve të planifikimit. Gjatë vitit 1988 u themelua **Qendra Koordinative Atlantike për situata të jashtëzakonshme**. Planifikimi për rastet e situatave të jashtëzakonshme është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm në bashkëpunimin e gjithmbarshëm programorë me vendet partnere dhe tani përbën segmentin më të madh joushtarak të aktiviteteve në kuadër të Partneritetit për Paqe.

Bashkëpunimi në sferën e shkencës dhe të ekologjisë

Dy programe të veçanta të NATO-s tubojnë shkencëtarë dhe specialistë për të punuar në problemet me interes të përbashkët - **programi civil i Komitetit Shkencorë të NATO-s dhe programi ekologjik dhe shoqëror i Komitetit për sfidat e shoqërisë bashkëkohore (CCSM)**. Rrjeti i krijuar përmes bashkëpunimit, që është bërë traditë mes shkencëtarëve dhe kërkesat për avancim teknik, gjithashtu përmbushin edhe qëllimin politik për ndërtimin e mirëkuptimit dhe të mirëbesimit ndërmjet komuniteteve me kultura dhe tradita të ndryshme.

Programet shkencore që ekzistojnë më se 45 vite, kohë më parë janë riorientuar që të fokusohen ekskluzivisht në çështjet kërkimore prioritare të mbrojtjes nga terrorizmi apo të ballafaqimit me kërcënime tjera kundër sigurisë. Në përputhje me iniciativat e Aleancës për t'u përballur me kërcënimet e reja, programi shkencor civil i NATO-s tani përqendron mbështetjen e vet në bashkëpunimin rreth çështjeve nga fushat e sipërpërmendura. Për t'i shprehur këto ndryshime fundamentale, është zgjedhur emri i ri për këtë program, i cili tani njihet si programi i NATO-s për "Sigurinë përmes shkencës".

Objektiv i programit të ri "Siguria përmes shkencës" është që t'i kontribuojë sigurisë së stabilitetit dhe solidaritetit midis kombeve, duke përdorur shkencën për zgjidhjen e problemeve. Bashkëpunimi, rrjetëzimi dhe ndërtimi i kapaciteteve, janë mjetet që shfrytëzohen për arritjen e këtij qëllimi. Lloje të ndryshme donacionesh ju ofrohen shkencëtarëve të punësuar në NATO, në vendet partnere dhe në vendet që marrin pjesë në dialog, në mënyrë që të bashkëpunojnë në çështjet prioritare kërkimore. Donacionet gjithashtu ofrohen për të ndihmuar vendet partnere në krijimin e infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike.



